# DËSHMI ARKIVI

**A-461949**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Trump heq dorë nga aneksimi i Groenlandës. Firmoset marrëveshja tripalëshe për rritjen e pranisë ushtarake amerikane në ishullin Arktik |
| ADRESA | `https://versus.al/bota/trump-heq-dore-nga-aneksimi-i-groenlandes-firmoset-marreveshja-tripaleshe-p-i46982` |
| BURIMI | versus.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 05:18:11 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 16:42:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `186cd0a03f2fe46b729555b19f1e09d09e783b8d81b658a8e2e2288ca1af03dc` |
| TEKSTI | `a978d8bbc50569acce2d0c9e9c706698e2364e309faaea10659ad75008248c83` |
| PAMJA | `8f851afaa8d7c7c407453ea8966cfdf7c0182d8c05943deae0bee2dd79beee3f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8b3e930115890f22a3c6af2aaa301683cd20beec9931ebc16fbea931a16b2695` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8b3e930115890f22a3c6af2aaa301683cd20beec9931ebc16fbea931a16b2695`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[SPAK i caktoi masën "arrest shtëpie", Vlora Hyseni arrestohet në kufi me Kosovën! Rama nga SHBA e shkarkon nga detyra](#)

22 Shtator 2026, 10:48

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në




- Politikë
- aktualitet
- MAGAZInë
- bota
- opinion



Created and monetized by
BOTA / 22 Shtator 2026, 18:42

# Trump heq dorë nga aneksimi i Groenlandës. Firmoset marrëveshja tripalëshe për rritjen e pranisë ushtarake amerikane në ishullin Arktik

Marrëveshja u firmos në Nju Jork, në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, pas muajsh tensionesh mes Uashingtonit dhe Kopenhagës lidhur me të ardhmen e Groenlandës.

Shkruar nga Versus




Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, kryeministrja e Danimarkës, Mette Frederiksen, dhe kryeministri i Groenlandës, Jens-Frederik Nielsen, kanë nënshkruar të martën një marrëveshje të re për sigurinë e Groenlandës, që parashikon zgjerimin e pranisë ushtarake amerikane në ishullin Arktik.

Marrëveshja u firmos në Nju Jork, në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, pas muajsh tensionesh mes Uashingtonit dhe Kopenhagës lidhur me të ardhmen e Groenlandës.

Paketa e re e sigurisë nuk parashikon aneksimin apo blerjen e Groenlandës nga Shtetet e Bashkuara. Territori mbetet nën sovranitetin e Mbretërisë së Danimarkës, ndërsa marrëveshja synon të rrisë bashkëpunimin ushtarak dhe praninë amerikane në një prej zonave më strategjike të Arktikut.

Sipas raportimeve, marrëveshja parashikon forcimin e kapaciteteve ushtarake amerikane dhe përdorimin e zgjeruar të infrastrukturës ushtarake në Groenlandë. SHBA-ja ka aktualisht bazën hapësinore Pituffik, ndërsa marrëveshja e re lidhet edhe me zhvillimin dhe rikthimin në përdorim të instalimeve të tjera ushtarake.

Një nga objektivat kryesore të marrëveshjes është parandalimi i krijimit të pranisë ushtarake të vendeve jashtë NATO-s në Groenlandë, në një kohë kur Arktiku po merr rëndësi gjithnjë e më të madhe strategjike për shkak të konkurrencës mes fuqive të mëdha.

Marrëveshja vjen pas deklaratave të përsëritura të Trump për interesin e SHBA-së për të marrë kontrollin e Groenlandës. Këto deklarata kishin shkaktuar tensione me Danimarkën dhe kundërshtime nga autoritetet groenlandeze.

Me marrëveshjen e re, Uashingtoni zgjeron bashkëpunimin dhe praninë e tij të sigurisë në ishull, ndërsa Danimarka dhe Groenlanda ruajnë sovranitetin dhe të drejtën e vetëvendosjes së popullsisë groenlandeze./**Versus.al**

Poll



BOTA

[**Italia paralajmëroi ndalimin e burkës në shkolla, Erdogan në OKB: Islamofobia po përhapet në Perëndim!**]

22 Shtator 2026, 19:28

^ekstrakti^





BOTA

**["Regjimi komunist do të bjerë"! Trump paralajmëron ndërhyrje në Kubë, delegacioni kubanez braktis sallën e OKB]**

22 Shtator 2026, 19:14

^ekstrakti^



BOTA

**[BE zgjat me 3 vjet sanksionet ruse, përjashton dy miliarderët Usmanov dhe Fridman]**

22 Shtator 2026, 17:35

^ekstrakti^



BOTA

**["Ujku i Detit", Turqia nis stërvitjen e madhe ushtarake]**

22 Shtator 2026, 14:51

^ekstrakti^



BOTA

**[Përsëritet tragjedia në Turqi, nxënësi i bullizuar merr armën e gjyshit dhe plagos 11 të mitur]**

[illegible]

22 Shtator 2026, 13:36

^ekstrakti^



BOTA

["Kriminel lufte", Mamdani "dorëzohet" për vizitën e Netanyahut: Nju Jorku nuk mund ta arrestojë]

22 Shtator 2026, 08:46

^ekstrakti^



BOTA

[VIDEO/ Shokuese në Barcelonë! 5 burra të veshur me uniforma policie rrëmbejnë në mes të trafikut një person]

21 Shtator 2026, 20:38

^ekstrakti^



BOTA

[Diskutime me Trumpin për tarifat dhe Tajvanin, Xi Jinping njofton vizitë dy ditore në SHBA]

21 Shtator 2026, 14:40

^ekstrakti^

[Të fundit]



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.